

## **Fjalimi i imamit Mr. Rejhan ef. Neziri me rastin e 30 vjetorit të xhamisë:**

I nderuari kryetar i Kreuzlingenit, z. T. Niederberger

Të nderuar mysafirë nga vendlindja e nga Zvicra, es-selamu alejkum!

Xhami jonë sonte ka të drejtë të gëzohet e të festojë. Të festojë sukseset e përbashkëta të arritura me fljimin dhe sakrificen e secilit prej nesh këtu e të tjerëve që nuk janë më në mesin tonë. Allahu i shpërbleftë të gjithë ata me xhennetet më të larta të Tij!

Unë si imam jam i angazhuar këtu qe 20 vjet dhe e kam vazhduar prej aty ku e kanë lënë imamët e mëparshëm, të cilët për fat të mirë të gjithë sonte i kemi në mesin tonë. Allahu i shpërbleftë me Xhennetin Firdeus!

Filozofia ime si imam ka qenë që fillimisht të bëjmë forcimin dhe konsolidimin e brendshëm të xhamisë e të xhematit: me namazet ditore e javore, me ligjëratat në dy gjuhë: shqip dhe gjermanisht, me mësimin fetar në xhami e më vonë edhe në shkollat publike të Kreuzlingenit, me kremtimin e festave fetare si dhe duke i shoqëruar muslimanët e këtushëm shpirtërisht në çdo fazë të jetës së tyre.

Hapi i dytë ka qenë krijimi i strukturave tona të brendshme si: forumi i të rinjve, forumi i grave dhe forumi i të shkolluarve në Zvicër „Networking“.

Hapi i tretë ka qenë hapja ndaj shoqërisë duke marrë pjesë në themelimin, ngritjen dhe mbështetjen e shoqatave e organizatave islame e të tjera këtu në Zvicër edhe atë që nga niveli komunal, ai kantonal dhe federal, siç patët mundësinë të njoftoheni edhe nga filmi prezantues i xhamisë sonë.

Hapi i radhës i imi është krijimi i një interpretimi dhe diskursi të ri të Islamit, që do ta sillte Islamin këtu dhe sot, pra që Islami të mos shihet këtu si një trup i huaj, porse si një element dhe faktor i fuqishëm në ngritjen dhe zhvillimin e jetës së përbashkët me të gjithë në këtë shtet liberal e demokratik.

Me fjalë të tjera, unë si imam dhe si mësues i lëndës fetare, angazhohem që me ligjëratat, mësimet, seminarët, artikujt shkencorë e librat e mi autorialë e të përkthyer, të kontribuoj që Islami këtu dhe sot të kuptohet me nivelin e dijes e të vetëdijes së tanishme e të këtushme. Ky është një proces që do të zgjasë. Dhe unë jam i gatshëm që këtë ta vijoj deri në fund të jetës sime.

Ju falënderoj për durimin dhe kalofshi çaste të këndshme!

## **Das Grusswort des Imams Rehan Neziri:**

Sehr geehrter Herr Stadtpräsident, T. Niederberger

Sehr geehrte Gäste aus unseren Heimatländern und aus der Schweiz

Ich begrüße euch alle mit es-selamu alejkum wr.

Unsere Moschee hat verdient, heute Abend zu feiern... Wir feiern den gemeinsamen Erfolg unserer Mitglieder und Unterstützer... Möge Allah sie alle reichlich belohnen!

Ich als Imam bin hier seit 20 Jahren tätig und habe die Arbeit weitergeführt, die die früheren Imame bis dahin erreicht haben... Glücklicherweise sind alle diese Imame heute Abend hier mit uns zusammen. Möge Allah sie ebenfalls reichlich belohnen!

Meine Philosophie als Imam war zunächst die inneren Strukturen der Moscheegemeinde zu stärken und sie weiter zu entwickeln. Da haben wir die verschiedenen Foren gegründet: das Jugendforum, das Frauenforum und seit neuestem das «Networking»-Forum.

Mein nächster Schritt war die Öffnung nach draussen. Sodas wir als Moschee entweder Mitbegründer oder aktive Unterstützer verschiedener islamischen und sonstigen Organisationen in der Gemeinde-, Kantonale- und Bundesebene mitgewirkt haben. Das tun wir weiterhin aktiv...

Mein letzter Schritt ist, eine neue Interpretation und einen neuen Diskurs des Islams in hier und heute zu schaffen, sodass der Islam hier nicht als Fremdkörper, sondern als aktiver Mitgestalter dieser Gesellschaft, Kultur und Zusammenleben gesehen wird. Das tue ich durch meine Vorträge, Unterrichte, Seminare, wissenschaftliche Beiträge in der albanischen und deutschen Sprache, sowie durch meinen autorialen und überstetzten Büchern aus verschiedenen Sprachen. Dies ist ein Prozess, der dauern wird... Und ich bin bereit, bis zum Ende meines Lebens und nach meinen Möglichkeiten, diesem Prozess Folge zu leisten.

Ich bedanke mich ganz herzlich für eure Aufmerksamkeit und wünsche euch viel Vergnügen beim heutigen Abend!